



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

Nr. 263/1 prot.

Tiranë, më 12.9.2022

URDHËR

Nr. 24 datë, 12.9 2022

PËR

**MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR SHTYRJEN E AFATET KOHORE QË LIDHEN
ME KUALIFIKIMET E MËSIMDHËNËSVE TË AFP PËR VITIN 2022**


Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Nr. 21, datë 27.06.2022, “Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimitdhënësve të kulturës profesionale në Arsimin dhe Formimin Profesional”, referuar Nenit 16, pikës 2 të këtij udhëzimi: “Për afatet kohore që lidhen me kualifikimet e mësimitdhënësve të AFP për vitin 2022, AKAFPK, duke konsideruar vështirësitë e krijuara në komunikim për shkak të sulmit kibernetik dhe bllokimit të faqes së internetit të AKAFPK, informon shkollat profesionale me anë të këtij Udhëzuesi për shtyrjen e afateve kohore që lidhen me procedurat e kualifikimit të mësimitdhënësve të AFP, për vitin 2022.

URDHËROJ

Miratimin e “Udhëzuesit për shtyrjen e afateve kohore që lidhen me kualifikimet e mësimitdhënësve të AFP, për vitin 2022”, sipas tekstit që i bashkëlidhur këtij urdhëri dhe është pjesë përbërëse.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ejvis Gishti

Konceptoi: Alqi Mustafai 
Drejtor i Drejtorisë së ZHPO
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Tiranë



Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë
Tel. +355 42237087

Web site: www.akafp.gov.al

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

UDHËZUES

Për shtyrjen e afateve kohore që lidhen me procedurat e kualifikimit të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP, për vitin 2022.

Datë 12.09.2022

Nëpërmjet këtij Udhëzuesi, shtyhen afatet kohore që lidhen me procedurat e kualifikimit të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP, për vitin 2022. Afatet e treguara në Udhëzuesin e mëparshëm të datës 08.07.2022, shfuqizohen.

Ky Udhëzues, bazohet në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Nr. 21, datë 27.06.2022, "Për kualifikimin e vazhduar profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në Arsimin dhe Formimin Profesional".

Kjo shtyrje e afateve kohore që lidhen me procedurat e kualifikimit të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP, bëhet si pasojë e sulmit kibernetik dhe bllokimit të faqes së internetit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) që pamundësoi komunikimin e AKAFPK me palët e interesuara për procesin e kualifikimit.

Palët e angazhuara në kualifikimin e mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP (AKAFPK, AKPA, ofruesit e AFP, mësimdhënësit e kulturës profesionale) duhet të zbatojnë kërkesat e Udhëzimit Nr. 21, datë 27.06.2022, si dhe afatet kohore përkatëse, tashmë të shtyra, sikurse tregohen në këtë Udhëzues. Për të gjitha kërkesat e tjera të kualifikimit, të cilat nuk përmbajnë afate kohore, palët e angazhuara duhet të zbatojnë nenet e Udhëzimit Nr. 21, datë 27.06.2022.

Ky Udhëzues me afate të shtyra, si dhe Udhëzimi Nr. 21, datë 27.06.2022 janë të publikuara në faqen e internetit të AKAFPK, në linkun <https://www.akafp.gov.al/dokumente-kurrikulare/udhezues/>

Tabela e veprimtarive për kualifikimin, me afatet e shtyra, vetëm për vitin 2022.

Nr	Veprimtaritë për kualifikimin - 2022	Afatet kohore të ndryshuara	Përgjegjësitë
1	Procedura për fitimin e kategorive të kualifikimit (atestimit) nga mësimdhënësit e kulturës profesionale për vitin 2021-22, kryhet në periudhën:	Korrik – nëntor 2022	AKAFPK, AKPA, ofruesit e AFP, mësimdhënësit e AFP

2	Publikimi i "Standardit të profesionit të mësimdhënësit në AFP", i dy "Programeve të kualifikimit të mësimdhënësve në AFP" dhe i materialeve mbështetëse.	Deri në 12 shtator 22	AKAFPK
3	Kërkesa me shkrim në drejtorinë e ofruesit, për të kryer kualifikimin, e mësimdhënësve që plotësojnë kushtet për kualifikimin 5, 10 dhe 20 vjeçar (sipas grupeve A dhe B)	Deri në 24 gusht 22	Mësimdhënësit kandidatë për kualifikimin
4	Çdo drejtori e ofruesve, pasi verifikon kërkesat, dërgon zyrtarisht në AKPA, listën emërore, grupin dhe kategorinë e kualifikimit, të dhënat për vitet e punës dhe kontaktet e kandidatëve që kanë aplikuar dhe që plotësojnë kushtet	Deri në 26 Gusht 22	Drejtoritë e ofruesve të AFP
5	Saktësimi nga AKPA dhe dërgimi në AKAFPK i listës së mësimdhënësve kandidatë për kualifikimin, sipas grupeve dhe kategorive	Deri në 31 gusht 22	AKPA
6	Njoftimi (me e-mail) nga AKAFPK i kandidatëve për fillimin e procedurës, hapat që duhet të ndjekin dhe adresen ku duhet të dërgojnë dokumentet	Deri në 7 shtator 22	AKAFPK
	Portofoli i kualifikimit		
7	Krijimi i Komisionit për Kualifikimin e Mësimdhënësve të AFP (KKM), me Urdhër të brendshëm	Deri në 12 shtator 22	AKAFPK
8	Përgatitja dhe plotësimi nga mësimdhënësit e dosjes me dokumentacionin e kërkuar për kualifikimin. Plotësimi i trajnimeve të akredituara, sipas kërkesave.	Deri në 19 shtator 22	Mësimdhënësit kandidatë për kualifikimin
9	Dërgimi në adresën e AKAFPK i dokumentacionit (portofolit), nga kandidatet	Deri në 19 shtator 22	Mësimdhënësit kandidatë
10	Shqyrtimi dhe skedimi i portofoleve të kandidatëve nga AKAFPK	Deri në 26 shtator 22	AKAFPK
11	Plotësimi i dokumentacionit të munguar të kandidatëve	Deri në 30 shtator 22	AKAFPK
12	Vlerësimi i portofolit të çdo kandidati dhe njoftimi i tyre për pikët e fituara	Deri në 14 tetor 22	AKAFPK
13	Pranimi dhe shqyrtimi i ankimimeve të mundëshme	Deri në 21 tetor 22	AKAFPK
14	Protokollimi i vlerësimeve përfundimtare të portofoleve dhe njoftimi i kandidatëve	Deri në 24 tetor 22	AKAFPK
	Provimet e kualifikimit		
15	Publikimi në faqen e Agjencisë, i njoftimit për Provimet (listat, datat, orët, kohëzgjatjet, vendin etj.).	25 tetor 22	AKAFPK

16	Realizimi (administrimi) i provimeve të mësimdhënësve, të ndarë në grupe deri 15 persona.	29 tetor 22	AKAFPK
17	Vlerësimi i testeve të plotësuara nga kandidatët	31 tetor – 2 nëntor 22	AKAFPK
18	Njoftimi me e-mail i pjesmarrësve për rezultatet	3 nëntor 22	AKAFPK
19	Pranimi dhe shqyrtimi ankimeve, njoftimi për rezultatet përfundimtare të provimit	4-10 nëntor 22	AKAFPK
	<i>Vlerësimi përfundimtar dhe Certifikimi</i>		
20	Llogaritja e pikëve përfundimtare të kandidatëve	11 nëntor 22	AKAFPK
21	Njoftimi me e-mail i kandidatëve për rezultatin	11 nëntor 22	AKAFPK
22	Pranimi dhe shqyrtimi ankimeve, njoftimi për rezultatet përfundimtare	14-17 nëntor 22	AKAFPK
23	Dërgimi në AKPA i listës emërore të pjesmarrësve me rezultatet e arritura dhe shkallët e fituara	18 nëntor 22	AKAFPK
24	Dërgimi me postë i certifikatave të mësimdhënësve në adresat e ofruesve	21 nëntor 22	AKAFPK
25	Plotësimi i regjistrit të certifikatave të kualifikimit në bankën e të dhënave të AKAFPK	21 nëntor 22	AKAFPK